

**RESOLUTION OF THE CEO
OF
MELIÁ HOTELS INTERNATIONAL, S.A.**

DATED 30.07.2024

This 30 day of July, 2024 (two thousand twenty-four), the company Meliá Hotels International, S.A., incorporated under the laws of Spain, with registered seat in Calle Gremi Boters, 24, 07009 Palma de Mallorca, Spain, Spanish fiscal identification number (N.I.F.) A-78304516, registered in the Commercial Register of Palma de Mallorca with reg. reference Paper PM-22603, Volume 1335, sheet 100, duly represented by Gabriel Escarrer Jaume, in his capacity of President:

RESOLVED

1. To approve the establishment of a fully owned subsidiary in Albania in accordance with the legislation of the Republic of Albania, with the following data:

- **Legal Form:** Limited Liability Company
- **Name:** Meliá Hotels Albania Sh.p.k.
- **Duration:** Indefinite
- **Registered Office:** Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, kati IV, Tirana, Albania
- **Share Capital:** ALL 100
- **Object of activity:** The company will offer extensive hotel and catering services, manages tourism facilities, engages in related consulting and investment activities, and promotes tourism-related technologies and businesses.
- **Quotaholder:** 100% owned by Meliá Hotels International, S.A.

2. To approve the Act of Incorporation and Articles of Association of Meliá Hotels Albania Sh.p.k. as per the attached text.

3. To appoint as Administrators of Meliá Hotels Albania Sh.p.k., Mr. Luis Alfonso Elizondo Fernandez, born on 05.01.1978, in Lima, Peru, identified with the Spanish passport No. ZDC862227, and Mr. Alfredo Aznar Riquelme, born on 17.07.1970, in Barcelona, Spain, identified with the Spanish passport No. XDE602870 and to grant them the powers of the administration and the legal representation of the

**VENDIM I ADMINISTRATORIT
TE
MELIÁ HOTELS INTERNATIONAL, S.A.**

30.07.2024

Sot, më datë 30.07.2024 (dy mijë e njëzet e katër), shoqëria Meliá Hotels International, S.A., e themeluar në përputhje me ligjet e Spanjës, me seli në Calle Gremi Boters, 24, 07009 Palma de Mallorca, Spanjë, numër fiskal spanjoll (N.I.F.) A-78304516, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Palma de Mallorca me referencë regjistri PM-22603, Volumi 1335, faqe 100, e përfaqësuar nga Gabriel Escarrer Jaume, në cilësinë e Presidentit:

VENDOSI

1. Të themelojë një shoqëri plotësisht të kontrolluar në Shqipëri në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, me të dhënat e mëposhtme:

- **Forma Ligjore:** Shoqëri me Përgjegjësi te Kufizuar
- **Emri:** Meliá Hotels Albania Sh.p.k.
- **Kohëzgjatja:** E pacaktuar
- **Selia:** Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, kati IV, Tiranë, Shqipëri
- **Kapitali aksionar:** 100 Lekë
- **Objekti i Veprimtarisë:** Shoqëria do të ofrojë shërbime të zgjeruara hotelerie dhe katering, do të menaxhojë objekte turistike, do të angazhohet në shërbime të lidhura konsulence dhe investimesh, dhe do të promovojë teknologji dhe biznese të lidhura me turizmin.
- **Ortak:** 100% e zotëruar nga Meliá Hotels International, S.A.

2. Të miratojë Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë Meliá Hotels Albania Sh.p.k. sipas tekstit bashkangjitur.

3. Të emërojë Administratorë të Meliá Hotels Albania Sh.p.k., Z. Luis Alfonso Elizondo Fernandez, lindur më 05.01.1978, në Lima, Peru, i identifikuar me pasaportën spanjolle nr. ZDC862227, dhe Z. Alfredo Aznar Riquelme, lindur më 17.07.1970, në Barcelonë, Spanjë, i identifikuar me pasaportën nr. XDE602870, dhe t'i japë atyre kompetencat e administrimit dhe përfaqësimit ligjor të shoqërisë së re në përputhje me Statutin e saj.

new company in accordance with its Articles of Association.

4. To authorize the administrators of Meliá Hotels Albania Sh.p.k., and/or Mrs. Ledia Beci, member of the law office Hoxha, Memi & Hoxha Sh.p.k, holder of the Albanian ID card no. 033140003, to perform all actions and procedures for (i) the incorporation and registration of Meliá Hotels Albania Sh.p.k. with the Albanian Commercial Register held by the Albanian National Business Center, (ii) the registration of the ultimate beneficial owner/s of Meliá Hotels Albania Sh.p.k. with the Register of Beneficial Owners held by the Albanian National Business Center, as well as (iii) for any registration with other Albanian public institutions as required during the incorporation phase. The representative/s shall have the right to sign and file all necessary documents of the new company to be established in Albania. Moreover, the representative/s shall be also entitled to appoint and authorize third persons as their representatives to conduct all or parts of the tasks granted to them by way of this Resolution.

4. Të autorizojë administratorët e Meliá Hotels Albania Sh.p.k., dhe/ose Znj. Ledia Beci, anëtare e zyrës ligjore Hoxha, Memi & Hoxha Sh.p.k, mbajtëse e kartës së identitetit shqiptare nr. 033140003, për të kryer të gjitha veprimet dhe procedurat për (i) themelimin dhe regjistrimin e Meliá Hotels Albania Sh.p.k. në Regjistrin Tregtar Shqiptar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, (ii) regjistrimin e pronarit/ëve përfitues të Meliá Hotels Albania Sh.p.k. në Regjistrin e Pronarëve Përfitues të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe (iii) për çdo regjistrim pranë institucioneve të tjera publike shqiptare sipas nevojës gjatë fazës së themelimit. Përfaqësuesit kanë të drejtën të nënshkruajnë dhe dorëzojnë të gjitha dokumentet e nevojshme të shoqërisë së re që do të themelohet në Shqipëri. Gjithashtu, përfaqësuesit kanë të drejtë të emërojnë dhe të autorizojnë persona të tretë si përfaqësues të tyre për të kryer të gjitha ose pjesë të detyrave të caktuara për ta me këtë Vendim.

Meliá Hotels International, S.A.

Represented by:/Përfaqësuar nga:

Gabriel Escarrer Jaume
PRESIDENT

MELIÁ HOTELS INTERNATIONAL S.A.

GREMI BOTERS, 24
07009 PALMA DE MALLORCA
CIF - A 78304816

Gabriel Escarrer Jaume
PRESIDENT

MELIÁ HOTELS INTERNATIONAL S.A.

GREMI BOTERS, 24
07009 PALMA DE MALLORCA
CIF - A 78304816

**ACT OF INCORPORATION AND
STATUTE
OF THE LIMITED LIABILITY
COMPANY
MELIA HOTELS ALBANIA SHPK**

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
MELIA HOTELS ALBANIA SHPK**

ACT OF INCORPORATION AND
STATUTE
OF THE LIMITED LIABILITY
COMPANY
MELIA HOTELS ALBANIA SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
MELIA HOTELS ALBANIA SHPK

TITLE I
COMPANY'S NAME, REGISTERED
OFFICE, DURATION, OBJECT

KREU I
EMRI I SHOQËRISË, SELIA,
KOHËZGJATJA, OBJEKTI

ARTICLE 1
COMPANY'S NAME

NENI 1
EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 The Company is established as a limited liability company denominated Meliá Hotels Albania SHPK, (hereinafter the "Company").
- Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është Meliá Hotels Albania SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

ARTICLE 2
REGISTERED OFFICE

NENI 2
SELIA

- 2.1 The registered office of the Company is in the address: Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, kati IV, Tirana, Albania.
- Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, kati IV.
- 2.2 The General Meeting may transfer the registered office of the Company. The managing body of the Company may establish and/or close branches and/or representative offices within the Republic of Albania and/or abroad.
- Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

ARTICLE 3
DURATION

NENI 3
KOHËZGJATJA

- 3.1 The duration of the Company is unlimited.
- Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

ARTICLE 4
OBJECT

NENI 4
OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 The object of the Company shall be the performance of all activities that a limited liability company may pursue according to the Albanian legislation, within the territory of the Republic of Albania or abroad, including:
- Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë në veçanti:

- a) The exercise of hotel and catering activity in the broadest sense, the management, in any form, of hotel enterprises, restaurants, public establishments, parking lots and all related and derived operations, the provision of food, entertainment and leisure in public establishments and all related and derived operations, including the operation and management of meeting rooms and convention centers, massage and beauty parlours, also with hairdressing services, of premises with special licenses for the sale of tobacco, gymnasiums, fitness centers and spa centers, swimming pools, dance halls, areas for the preparation and distribution of food for staff, staff canteens and reception, as well as the acquisition, exchange, sale, management (for its own account and not for the account of third parties), leasing, construction of real estate.
- Ushtrimin e veprimtarisë hoteliere dhe të kateringut në kuptimin e gjerë, administrimin, në çdo formë, të ndërmarrjeve hoteliere, restoranteve, objekteve publike, parkingjeve dhe të gjitha operacioneve të lidhura me to, ofrimin e ushqimit dhe argëtimit në institucionet publike dhe të gjitha aktivitetet e lidhura apo që rrjedhin nga to, duke përfshirë vënien në punë dhe menaxhimin e sallave të mbledhjeve dhe qendrave të konferencave, salloneve të masazhit dhe bukurisë, përfshirë me shërbime parukerie, të ambienteve me licenca të veçanta për shitjen e duhanit, sallave të sportit, qendrave të fitnesit dhe qendrave spa, pishinave, sallave të vallëzimit, hapësirave për përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit për personelin, mensave dhe ambienteve për pritjen e stafit, si dhe blerjen, shkëmbimin, shitjen, menaxhimin (për llogari të saj dhe jo për llogari të të tretëve), dhënien me qira, ndërtimin e pasurive të paluajtshme.
- b) The exercise of management and consulting activities in the hotel sector in the broadest sense and all related and derived operations, also through the transfer of personnel.
- Ushtrimin e veprimtarive të menaxhimit dhe të konsulencës në sektorin e hotelerisë në kuptimin e gjerë dhe të gjitha operacionet e lidhura apo që rrjedhin nga to, edhe nëpërmjet transferimit të personelit.
- c) The acquisition, ownership, operation, promotion, commercialization, development, administration and granting of rights over tourist and hotel facilities, and of any other facilities designed for activities related to tourism, leisure and recreation in any of the forms permitted by the law.
- Blerjen, zotërimin, menaxhimin, promovimin, tregtimin, zhvillimin, administrimin dhe dhënien e të drejtave mbi objektet turistike dhe hoteliere, si dhe mbi çdo objekt tjetër të projektuar për veprimtari që lidhen me turizmin, kohën e lirë dhe rekreacionin në cilëndo nga format e lejuara nga ligji.
- d) The acquisition, subscription, ownership and transmission of all types of securities, both public and private, both domestic and international, proxy of the share capital of companies whose corporate
- Blerjen, nënshkrimin, pronësinë dhe transmetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, publike dhe private, vendase dhe ndërkombëtare, mbajtjen e kapitalit aksionar të shoqërive objekti i së cilave

- object is the operation and/or ownership of the activities indicated above.
- është kryerja dhe/ose zotërimi i aktiviteteve të përmendura më lart.
- e) The acquisition, ownership, operation, management, commercialization and granting of rights over all types of goods and services for tourist and hotel facilities, or any other facilities designed for activities related to tourism, leisure and recreation.
- Blerjen, zotërimin, vënien në punë, menaxhimin, tregtimin dhe dhënien e të drejtave mbi të gjitha llojet e mallrave dhe shërbimeve për objektet turistike dhe hoteliere, ose çdo objekt tjetër të projektuar për aktivitete që lidhen me turizmin, kohën e lirë dhe rekreacionin.
- f) The acquisition, development, commercialization and granting of rights over any know-how or technology related to tourism, hotels, leisure or recreation.
- Blerjen, zhvillimin, tregtimin dhe dhënien e të drejtave mbi çdo njohuri ose teknologji që lidhet me turizmin, hotelet, kohën e lirë ose rekreacionin.
- g) The promotion of all types of business related to tourism, hotels, leisure and recreation, as well as participation in the creation, development and operation of new business, establishments or entities involved in tourism, hotels, leisure or recreation.
- Promovimin e të gjitha llojeve të biznesit që kanë të bëjnë me turizmin, hotelerinë, kohën e lirë dhe rekreacionin, si dhe pjesëmarrjen në krijimin, zhvillimin dhe funksionimin e bizneseve të reja, ndërmarrjeve ose subjekteve të përfshira në turizëm, hoteleri, argëtim ose rekreacion.
- 4.2 In the pursuit of its objects, the company may:
- Për realizimin e objektit të saj, shoqëria mund:
- a) Enter into all kinds of contracts and agreements with natural persons or legal entities, operating under private or public law, states or organizations, whether domestic or international.
- Të lidhë të gjitha llojet e kontratave dhe marrëveshjeve me persona fizikë ose juridikë, që ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të drejtës private ose publike, shtete ose organizata, qofshin ato vendase ose ndërkombëtare.
- b) Establish branches or agencies anywhere in Albania or abroad.
- Të themelojë degë apo agjenci kudo në Shqipëri apo jashtë saj.
- c) Represent for a profit domestic or international natural persons or legal entities, of any corporate form, pursuing the same or similar object as the Company.
- Të përfaqësojë për qëllime fitimi persona fizikë ose juridikë vendas ose ndërkombëtarë, të çdo forme, që kryejnë të njëjtin objekt ose të ngjashëm me Shoqërinë.
- d) Establish all kinds of companies, joint ventures together with natural persons or legal entities or with associates of the
- Të themelojë të gjitha llojet e shoqërive, sipërmarrjeve të përbashkëta së bashku me persona fizikë ose juridikë ose me

- persons or entities pursuing the same or similar objects as the Company, and participate or cooperate with companies, joint ventures or enterprises of any kind, whether domestic or international, pursuing the same or similar object as the Company.
- bashkëpunëtorë të personave ose subjekteve që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me Shoqërinë, dhe të marrë pjesë ose të bashkëpunojë me shoqëri, sipërmarrje të përbashkëta ose ndërmarrje të çdo lloji, qofshin ato vendase ose ndërkombëtare, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me Shoqërinë.
- e) Enter into loan agreements, accept by resolution of the directors personal or other guarantees, with other companies and enterprises in general, whether domestic or international, joint ventures wherein the Company participates or with which the Company does business in any manner, issue bills of exchange, notes to order, checks, bonds or other securities or titles for the account of the Company and securities.
- Të lidhë marrëveshje kredie, pranojë me vendim të drejtorëve garanci personale ose të tjera, me shoqëri dhe ndërmarrje të tjera në përgjithësi, qofshin ato vendase apo ndërkombëtare, sipërmarrje të përbashkëta ku Shoqëria merr pjesë ose me të cilat Shoqëria bën biznes në çfarëdo mënyre, të lëshojë tituj këmbimi, urdhra për tituj, çeqe, obligacione ose tituj të tjerë për llogari të Shoqërisë dhe letra me vlerë.
- f) Carry out any relevant commercial or other activity and undertake all actual or legal agreements, which are directly or indirectly related to the corporate objects or which further the accomplishment of the corporate objects.
- Të kryejë çdo aktivitet tregtar apo tjetër dhe të marrë përsipër të gjitha marrëveshjet aktuale apo ligjore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë lidhen me objektin e Shoqërisë apo të cilat shërbejnë për realizimin e këtij objekti.
- g) Acquire shares in other companies pursuing similar objects.
- Të blejë pjesëmarrje në shoqëri të tjera që kryejnë aktivitet të ngjashëm.
- h) Carry out all the business activities under the Albanian law which pertain to its objects.
- Të kryejë të gjitha aktivitetet tregtare sipas ligjit shqiptar që lidhen me objektin e saj.
- 4.3 In addition, the Company may carry out any other activity related to, consequent to or connected with its main object.
- Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

**TITLE II
CAPITAL, INCREASE AND DECREASE
OF CAPITAL**

**ARTICLE 5
COMPANY'S CAPITAL**

**KREU II
KAPITALI, ZMADHIMI DHE
ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

**NENI 5
KAPITALI I SHOQËRISË**

- 5.1 The Company's capital is 100 Leke, consisting of 1 (one) quota. The Company's capital is subscribed and paid-up as follows: Kapitali i Shoqërisë është 100 Lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet dhe paguhet tërësisht si më poshtë:
- Meliá Hotels International, S.A. a company incorporated under the laws of Spain, with registered seat in Calle Gremi Boters, 24, 07009 Palma de Mallorca, Spain, with Spanish fiscal identification number (N.I.F.) A-78304516 and registered in the Commercial Register of Palma de Mallorca with reg. no. Paper PM-22603, Volume 1335, sheet 100. Meliá Hotels International, S.A., një shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet e Spanjës, me seli në Calle Gremi Boters, 24, 07009 Palma de Mallorca, Spanjë, numër fiskal spanjoll (N.I.F.) A-78304516, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Palma de Mallorca me referencë regjistri PM-22603, Volumi 1335, faqe 100.
- 5.2 The quotas of Company's capital shall not be transferred without the prior written approval of the other quotaholders. The quotaholders shall have the right of first refusal with regard to quotas fully or partially transferred by the selling quotaholder. Within 30 (thirty) days starting from the offer for sale of the quota, the quotaholders shall have the right to purchase the quota at the price and the payment modalities agreed with the selling quotaholder. Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotat përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë. Në rast se një nga ortakët dëshiron të cedojë, plotësisht apo pjesërisht, kuotën e tij, duhet t'ia ofrojë kuotën e tij për blerje ortakëve të Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortakët do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e ofruar në shitje sipas çmimit dhe mënyrave të pagesës për të cilat kanë rënë dakord me ortakun shitës.
- 5.3 Except for the provisions of art. 5.2, each quotaholder may freely sell, fully or partially, his quota to a company which is controlled by this quotaholder. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 5.2, secili ortak mund të shesë lirisht, plotësisht ose pjesërisht, kuotën e tij një shoqërie të kontrolluar nga ky ortak.

**ARTICLE 6
TRANSFER IN CASE OF
INHERITANCE OR BANKRUPTCY**

**NENI 6
KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI
OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT TË
ORTAKUT**

- 6.1 If a quotaholder dies the survivor or survivors where he was a joint holder, and his heirs where he was a sole holder or the only survivor of joint holders, shall be the only persons recognized by the Company as having any title to his quota; but nothing herein contained shall release the estate of a deceased member from any Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotëruar ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga Shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e

liability in respect of any quota which had been held by him solely or jointly.

ortakut të vdekur nuk çlirohet nga çdo përgjegjësi në lidhje me çdo kuotë të zotëruar vetëm nga ai apo së bashku me persona të tjerë.

6.2 A person becoming entitled to a quota in consequence of the death or bankruptcy of a quotaholder shall have the rights to which he would be entitled if he were the holder of the quota, except that he shall not, before being registered with the National Business Center (NBC) as the holder of the quota, be entitled in respect of it to attend or vote at any General Meeting.

Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB si zotëruesi i kuotës.

ARTICLE 7 INCREASE OF CAPITAL

NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

7.1 The General Meeting may increase the Company's capital by qualified resolution adopted with the quorum provided in art. 9.12 of this Act of Incorporation and Statute. The resolution of the General Meeting on the increase of capital shall be communicated by written notice to the quotaholders who were called and were not present at the General Meeting that resolved on the increase.

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.

7.2 In case of capital increase, all quotaholders have the right to subscribe the increase, in cash or in kind, in proportion to their quotas held in Company capital.

Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.

7.3 In case some of the quotaholders waive their right to subscribe for their portion, the unsubscribed capital may be subscribed by the other quotaholders. In this case, such quotaholders may re-exercise the right for the unsubscribed capital, in proportion to their respective quota.

Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

ARTICLE 8 DECREASE OF CAPITAL

NENI 8 ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 The General Meeting may decrease the Company's capital by qualified resolution adopted with the quorum provided in art. 9.12 of this Act of Incorporation and Statute. In any case the Company's capital may not be reduced under the limits provided by the law. Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 The quotaholders afford the reduction of the Company's capital, in proportion to their participation in the Company's capital. Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

**TITLE III
GENERAL MEETING**

**ARTICLE 9
GENERAL MEETING**

**KREU III
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**NENI 9
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

- 9.1 The decision-making body of the Company is the General Meeting. The General Meeting is entitled to resolve on all the issues attributed by the laws in force in the Republic of Albania, this Act of Incorporation and Statute and/or any separate Quotaholders Agreement. Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo Marrëveshje Ortakësh të veçantë.
- 9.2 Any quotaholder is entitled to attend the meetings of the General Meeting, to represent his own opinion and exercise its voting rights in proportion to the quotas owned in the capital of the Company. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 9.3 Any quotaholder is entitled to appoint a representative, either a quotaholder or a third person, in the General Meeting by a written proxy. Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
- 9.4 The quotaholder may not delegate the voting right for a part of his quotas of the capital, if he personally votes for the remaining part. Ortakët nuk mund të delegojnë të drejtat e votës për pjesë të kuotës, nëse votojnë personalisht për pjesën e mbetur të kuotës.
- 9.5 The General Meeting may be called within the Republic of Albania or abroad. Quotaholders or proxies may be present by electronic means, including Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar

- audio/video conference call, in accordance with law on entrepreneurs and commercial companies and law on electronic communications. The General Meeting is considered to be held in the place where both the Chairman and the Secretary of the meeting are located, in order to allow the drafting and the signature of the minutes in the relevant book.
- 9.6 The General Meeting is called by the Administrator/s and by the quotaholders representing not less than 5% of the capital. The General Meeting shall be called by written notice or electronic means sent to each quotaholder at the addresses communicated to the Company, at least 15 (fifteen) days before the date of the meeting. The notice must contain the agenda to be discussed, location, time and date of the meeting.
- 9.7 The General Meeting will be considered as validly called, disregarding these formalities, if all quotaholders or their representatives are present and approve the agenda of the meeting.
- 9.8 General Meetings are chaired by the/an Administrator. The General Meeting appoints a secretary for each meeting among the present persons.
- 9.9 The resolutions of the General Meeting must be in writing and signed by the chairman and the secretary. The resolutions must include, upon request of the quotaholders, their declarations or observations as well.
- mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*) audio ose video, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali në librin përkatës.
- Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën në të cilën do të mbledhet Asambleja e Përgjithshme.
- Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
- Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

- 9.10 The General Meeting is called at least once per year within 6 (six) months from the closing of the financial year. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.11 The General Meeting is validly convoked and may decide, at the majority of the votes cast by the quotaholders, if the quotaholders representing more than 30% (thirty percent) of the capital are present or represented, except in the cases set out in art. 9.12 below. If such quorum is not reached, the General Meeting is convoked for the second call, within 30 (thirty) days from the first call. Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.
- 9.12 The General Meeting resolves upon the amendments to this Act of Incorporation and Statute, increase or decrease of Company share capital, distribution of profits, reorganization and dissolution of the Company with $\frac{3}{4}$ majority of votes of quotaholders representing more than 50% of Company capital. Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të $\frac{3}{4}$ të ortakëve pjesëmarrës që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 9.13 If the Company is owned by a sole shareholder, the sole shareholder shall exercise all rights and duties of the General Meeting. All resolutions taken in this capacity by the sole shareholder shall be entered into a special resolutions register, kept by the Company. Any unregistered resolution of the sole shareholder taken in this capacity, shall be null and void. Nëse Shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm, ortaku i vetëm do të ushtrojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm do të regjistrohen në një regjistër vendimesh që do të mbahet nga Shoqëria. Çdo vendim i ortakut të vetëm i paregjistruar në regjistrin e vendimeve do të jetë i pavlefshëm.

**TITLE IV
ADMINISTRATION OF THE
COMPANY**

**ARTICLE 10
ADMINISTRATION OF THE
COMPANY**

**KREU IV
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NENI 10
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

- 10.1 The Company is administered by the Administrators, appointed for a duration of 3 (three) years by the General Meeting. Shoqëria administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një

The Administrators may be reappointed and dismissed at any time by the General Meeting.

periudhë prej 3 (tre) vjetësh. Administratorët mund të rizgjidhen dhe shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

10.2 The Administrators have full powers with regard to the management of the Company and may carry out all acts considered as necessary for the accomplishment of the object of the Company, except for those powers reserved by law or this Act of Incorporation and Statute to the General Meeting or other Company bodies.

Administratorët zotërojnë kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejnë të gjitha aktet që konsiderojnë të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.

10.3 In particular, the Administrators shall not cause or, to the extent within its power of control, permit to occur, any of the following (each a "Major Decision") without the prior written consent of the General Meeting.

Në veçanti, Administratorët nuk do të miratojnë, apo për sa është në kontrollin e tyre, nuk do të lejojnë të ndodhë, ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme (secila një "Vendim Madhor") pa miratimin paraprak me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme.

- Confessing a judgement against the Company;
 - Selling, leasing, pledging or otherwise transferring all or substantially all of the assets of the Company;
 - Entering into any financing or refinancing on behalf of the Company, including the mortgaging or the placing of the suffering of any other encumbrance on any or all portion of the Company's assets;
 - Executing or delivering any assignment for the benefit of creditors of the Company;
 - Filing or consenting the filing of any bankruptcy, liquidation, insolvency or reorganization case or proceeding for the Company,
 - Seeking or consenting to the appointment of a receiver, assignee, trustee, sequestrator, custodian or any similar official for the Company or any substantial part of the Company's property.
- Pranimin e një përgjegjësie për llogari të Shoqërisë;
 - Shitjen, dhënien me qira, vendosjen e një pengu apo transferimin e të gjitha asetëve apo të gjitha asetëve thelbësore të Shoqërisë;
 - Lidhjen e ndonjë marrëveshjeje financimi apo rifinancimi për llogari të Shoqërisë, duke përfshirë hipotekimin apo vendosjen e ndonjë barre tjetër mbi ndonjë apo të gjitha asetet e Shoqërisë;
 - Nënshkrimi apo ofrimi i ndonjë cedimi për llogari të kreditorëve të Shoqërisë;
 - Depozitimi apo miratimi i depozitimeve të kërkesave për hapjen e procedurave të falimentimit, likuidimit, paaftësisë pagueuse ose riorganizimi apo procedure të ngjashme ndaj Shoqërisë,
 - Kërkimi apo dhënia e pëlqimit për caktimin e ndonjë marrësi, trustee, pranuesi, sekuestruesi, kujdestari apo të ngjashëm për Shoqërinë apo ndonjë pjesë thelbësore të asetëve të Shoqërisë.

- 10.4 The Administrators shall act in conformity with business policies determined by the General Meeting. The Administrators are responsible for the acts carried out during Company's management. The Administrators may delegate third parties' powers related to management of the Company. The Administrators shall be directly responsible for all acts performed by representatives with regard to Company's management.
- 10.5 The Administrators shall at all times act only in the interest of the Company. In the event of a conflict of interest, the relevant Administrator informs the quotaholders immediately and abstains from any actions regarding the subject of the conflict of interest until receipt of relevant instructions from the General Meeting.
- 10.6 The first Administrators of the Company shall be:
- Mr. Alfredo Aznar Riquelme, of age, born in Barcelona, Spain, on 17th July, 1970, holder of the Spanish passport no. XDE602870; and
 - Mr. Luis Elizondo Fernández, of age, born in Lima, Perú, on 5th January, 1978, holder of the Spanish passport no. XDC862227.
- 10.7 If more than one Administrators are appointed, they shall represent the Company jointly.
- Administratorët veprojnë në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratorët janë përgjegjës për veprimet e kryera ne administrimin e Shoqërisë. Administratorët mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë. Administratorët mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- Administratori/ët do të veprojnë në çdo kohë vetëm në interes të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori përkatës do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- Administratorët e pare të Shoqërisë do të jenë:
- Z. Alfredo Aznar Riquelme, madhor, lindur në Barcelonë, Spanjë, më datë 17 korrik 1970, mbajtës i pasaportës spanjolle nr. XDE602870; dhe
 - Z. Luis Elizondo Fernández, madhor, lindur në Lima, Perú, më datë 5 janar 1978, mbajtës i pasaportës spanjolle nr. XDC862227.
- Nëse emërohen më shumë se një Administratorë, ata do të përfaqësojnë Shoqërinë së bashku.

ARTICLE 11
ADMINISTRATOR/S RETRIBUTION

NENI 11
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATOREVE

- 11.1 The retribution of the Administrator/s is determined by the General Meeting.
- Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit/ve të Shoqërisë.

ARTICLE 12

NENI 12

**DISQUALIFICATION AND REMOVAL
OF ADMINISTRATOR/S**

**SKUALIFIKIMI DHE SHKARKIMI I
ADMINISTRATORIT/VE**

- 12.1 The office of Administrator shall be vacated if the Administrator:
- (a) ceases to be an Administrator by virtue of any provision of the law;
 - (b) enters into any insolvency procedure;
 - (c) is, or may be, suffering from mental disorder;
 - (d) resigns from his office by notice to the Company; or
 - (e) is absent without reason from its office for more than 6 (six) consecutive months and the General Meeting resolves that his office is vacated;
 - (f) is dismissed by the General Meeting.

- Detyra e Administratorit përfundon nëse:
- (a) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
 - (b) personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
 - (c) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
 - (d) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë,
 - (e) ka munguar pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra; ose
 - (f) ai shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme.

**TITLE V
FINANCIAL AUDIT OF THE
COMPANY,
FINANCIAL YEAR, ANNUAL
BALANCE SHEET, DIVIDENDS**

**KREU V
KONTROLLI FINANCIAR I
SHOQËRISË,
VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR,
DIVIDENDI**

**ARTICLE 13
FINANCIAL AUDIT**

**NENI 13
KONTROLLI FINANCIAR**

- 13.1 Company's financial audit shall be performed by a Certified Accountant, according to the Albanian legislation in force. If necessary or requested by the law, the General Meeting shall appoint one or more Certified Accountants.

- Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emëroje një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

**ARTICLE 14
FINANCIAL YEAR**

**NENI 14
VITI FINANCIAR**

- 14.1 The financial year of the Company commences on January 1st and closes on December 31st of each year.

- Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**ARTICLE 15
ANNUAL BALANCE SHEET**

**NENI 15
BILANCI VJETOR**

- | | | |
|------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 15.1 | The annual balance sheet, financial statements, inventory, reports of the Administrator/s and Certified Accountant (if appointed) are approved by the General Meeting. The Administrator/s shall present to the General Meeting for approval the Company's management report as well as the annual accounts. | Balanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorëve dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore. |
| 15.2 | The documents related to the financial year must be approved within 6 (six) months from the end of each financial year. | Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar. |

**ARTICLE 16
DIVIDENDS**

**NENI 16
DIVIDENDI**

- | | | |
|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 16.1 | After having met the requirements of the Law on Entrepreneurs and Commercial Companies, the Company may, by qualified resolution of the General Meeting, declare to distribute dividends in accordance with the respective rights of the quotaholders. | Pas plotësimit të parashikimeve të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë të Përgjithshme, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve. |
| 16.2 | Except as otherwise provided by the rights attached to the quota/s, all dividends shall be declared and paid according to and proportionally with the amounts effectively paid up of the quotas on which the dividend is paid. However, if any quota is issued on terms providing that it shall rank for dividend as from a particular date, that quota shall rank for dividend accordingly. | Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje dhe në përpjesëtim të drejtë me shumën e shlyera të kuotave për të cilat paguhet dividendi. Megjithatë, në rast se një kuotë emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit duke filluar nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht. |
| 16.3 | No dividend or other moneys payable in respect of a quota shall bear interest against the Company unless otherwise provided by the rights attached to the quota. | Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të jetë interesbartëse ndaj Shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën. |

**TITLE VI
DISSOLUTION AND LIQUIDATION,
APPLICABLE LAW,
SETTLEMENT OF DISPUTES**

**KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I
ZBATUESHEM
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

**ARTICLE 17
DISSOLUTION AND LIQUIDATION**

17.1 In case of dissolution and liquidation of the Company, the provisions of the Law on Entrepreneurs and Commercial Companies shall apply.

**ARTICLE 18
APPLICABLE LAW**

18.1 The Company shall carry out its activity in compliance with the provisions of this Act of Incorporation and Statute and the Albanian legislation. For all the cases not specifically regulated under this act, the Albanian legislation regulating commercial companies shall apply.

**ARTICLE 19
SETTLEMENT OF DISPUTES**

19.1 Any dispute arising between the Company and quotaholders, or between the quotaholders and/or their heirs and/or the Company, regarding the interpretation and/or execution of this Act of Incorporation and Statute, will be solved in an amicable way and settled directly between the interested parties. If an amicable settlement is not reached between the parties, Tirana District Court shall be competent to resolve on this dispute.

**ARTICLE 20
LANGUAGE**

20.1 The present Act of Incorporation and Statute is drafted in 3 (three) copies in English and in 3 (three) copies in Albanian language. For any controversy or dispute arising from the execution and/or interpretation of the present act, the English version will be binding and the sole having legal effect.

**NENI 17
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I
SHOQËRISË**

Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

**NENI 18
LIGJI I ZBATUESHËM**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

**NENI 19
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

**NENI 20
GJUHA**

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe në 3 (tre) kopje në gjuhën angleze, me vlerë të njëjtë secila. Në rast mospërputhjes, lidhur me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij akti, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë dhe do të jetë i vetmi version ligjërishet detyrues.


ACT OF INCORPORATION AND STATUTE OF MELIÀ HOTELS ALBANIA SHPK

SOLE QUOTAHOLDER

Melià Hotels International, S.A.

Represented by:

Gabriel Escarrer Jaume
President



30/04/2024

MELIÀ HOTELS INTERNATIONAL S.A.

**GREMI BOTERS, 24
07009 PALMA DE MALLORCA
CIF - A 78304316**